



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2019 merr këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE KUSHTUAR VIKTIMAVE TË LUFTËS SË VITIT 1999 TË LAGJES "SOFALIA"

- I. MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar viktimave të luftës së vitit 1999, të banorëve të lagjes Sofalia në Prishtinë.
- II.** Lokacioni për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar viktimave të luftës së vitit 1999, shtrihet në afërsi të rrugës “Lec Gradica”, në Taukbahçe, përkatësisht në pjesën e parcelës kadastrale nr. 2498-0, ZK Prishtinë, në pronësi, Pronë shoqërore, KK Prishtinë.
- III.** Ky vendim paraqet bazë për lejimin e vendosjes së pllakës përkujtimore.
- IV.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: pamje nga “Google Earth”, ortofoto e lokacionit, fotografi nga lokacioni dhe një propozimide për dukjen e kësaj pllake përkujtimore të propozuar nga kërkuesit.
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-0073699/19, më 29.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



ARSYETIM

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar viktimave të luftës së vitit 1999, të lagjes "Sofalia "

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën, e banorëve të lagjeve "Sofalia", "Bledi" dhe "Taukbahçe", 05. nr. 353/01-22249/19, të dt.30.01.2019, përkatësisht nga përfaqësuesi Enver Redenica, për caktimin e një lokacioni për vendosjen e një pllake përkujtimore. Kërkesa fillimisht është adresuar në Drejtorinë e Urbanizmit, ku është plotësuar më pastaj me pëlqim nga Organizata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Dega në Prishtinë.

Bazuar në përmbajtjen e kësaj kërkesë, për të përkujtuar të rënët e kësaj zone të Prishtinës, që u martirizuan në luftën e UÇK-së, kërkohet të ngrihet një pllakë përkujtimore, në afërsi të fushës së parë të tenisit, në zonën e Taukbahçes në Prishtinë.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, ka identifikuar lokacionin për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar viktimave të luftës së vitit 1999, i cili gjendet në kuadër të Planit rregullues të hollësishëm "Sofalia 2016-2024", i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01. nr. 031-247790, të dt. 04.10.2016, sipas të cilit kjo zonë është paraparë për gjelbërim.

Lokacioni i propozuar shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 2498-0, ZK Prishtinë, në pronësi - Pronë shoqërore, KK Prishtinë.

Vendosja e kësaj pllake përkujtimore është propozuar të vendoset në afërsi të rrugës "Lec Gradica" në Prishtinë, pranë fushës së parë të tenisit, dhe në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit sipas kërkesës së lartcekur.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset pllaka përkujtimore është sipërfaqe e gjelbëruar, andaj gjatë vendosjes së saj duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ambientit dhe rregullimit të parterit, si dhe ruajtjes së gjelbërimit.

Sa i përket madhësisë, formës dhe materialit të pllakës përkujtimore, është përcaktuar vetëm si propozimide, e cila më pastaj do të përpunohet.

Bashkangjitur:


- Pamje nga "Google Earth",
- Ortofoto e lokacionit,
- Propozimideja.




Pamje nga Google Earth




Ortofoto e lokacionit




Baza



Dukja Anësore



Dukja Ballore



Propozim-ide për dukjen e pllakës përkujtimore

Fotografi nga lokacioni

